

## Po faleminderit!

### Këto mund t'i derdhni te qesja bojë kafe:

- Lëvore frutash, perimesh, vezë dhe ushqim deti
- Kocka të vogla dhe mbeturina të mishit, të peshkut dhe të shpendit
- Pasta, oriz dhe patate
- Drithë dhe miell
- Bukë, keks, kuleç dhe bombone
- Telve nga kafeja, filtër kafeje dhe çaj
- Djathë dhe lyerje buke




## Jo faleminderit

### Këto nuk do t'i derdhni në qesen bojë kafe:

- Duhan, filtrin e duhanit, snus dhe çamçakëz
- Pelena, lecka të lagëta dhe artikuj të tjerë higjienik si psh. mbrojtjet intime
- Lule, bimë dhe mbeturina të bahçes
- Qese nga makina thithëse
- Zall mace dhe jashtëqitje nga kafshë shtëpiake

### Vini re se:

Qelqi, metalet, plastmasa dhe lloje pakosh të tjera duhet të sortohen tek qendra më e afërt e riciklimit.



Shayeje dhe ngjite te frigoriferi!

Foto: Christel Lind, Shippy, Litonipid Media AB, Göteborg. © Certifikuar dhe e shpëruar për ambientin 341 834

Guida e sortimit  
për mbeturinat nga  
ushqimi (mbeturinat  
organike)

## Sortoni mbeturinat e juaja organike dhe kontriboni për një ambient më të mirë!

Duke prodhuar gaz organik nga mbeturinat organike ne kontribuojmë për një impakt më të vogël në ambient dhe rrjedhimisht për një ambient më të mirë. Gazi organik zëvendëson lëndët djegëse fosile dhe përdoret si karburant nëpër për makinat e mbeturinave, autobusët dhe mjete të tjera. Ajo që mbetet nga prodhimi i gazit organik - plehu organik - një substitut perfekt i plehut artificial nëpër arrat tona. Në këtë mënyrë ne mbyllim qarkun.

Mbeturinat organike janë gjithçka që mbetet dhe që nuk rruhet më pasi ju të keni gatuar ose të keni ngrënë ushqimin tuaj. Mbetjet e mollës, copat e bukës, lëvoret e vesë, frutave dhe perimeve si dhe ato të peshkut dhe të kockave të mishit sortohen si mbeturina organike. Mbeturinat organike ju i sortoni në një qese bojë kafe prej letre e cila vendoset në një enë bojë kafe e paraparë për mbledhur mbeturinat organike.

Ju falënderojmë që ju sortoni mbeturinat tuaja organike!

## Kështu e përdorni qesen e mbeturinave organike

- ✓ Shpaloje qesen nga letra bojë kafe dhe vere tek mbajtësja. Është me rëndësi që mbajtësja e qeses të përdoret sepse ajo e bën që ajri të qarkullojë përreth qeses dhe ajo të mbetet e thatë.
- ✓ Shpalosni cepat përreth qeses së letrës sepse kjo bën që qesja të mbyllet më lehtë dhe më mirë.
- ✓ Mbyllni sërish qesen plotësisht duke rrotulluar cepat.
- ✓ Ndërroni qesen shpesh, çdo të dytën ose çdo të tretën ditë.
- ✓ Vendosni qesen në enën tuaj bojë kafe e cila është e paraparë për mbeturinat organike.

### Mos harroni që:

- ✓ Të lini mbeturinat organike të rrjedhin para se të hidhen
- ✓ Qërroni me gjithë qef fruta ose perime të thata direkt në qese
- ✓ Lini qesen të qëndrojë në mbajtësen e qeses
- ✓ Mbushni qesen maksimum deri tek vija e ndërprerë
- ✓ Mos i shtypni mbeturinat organike në qese



## Përse në nuk duhet të përdor qese plastmase për mbeturinat organike?

Mos përdorni kurrë qese plastmase për t'a futur qesen prej letre të cilën e jep VIVAB. Nëse plastmasa përfundon në procesin e gazit organik, sasi të mëdha të mbeturinave organike do të duhen të hidhen. Enët bojë kafe të cilat përmbajnë plastmasë nuk shprazen por sinjalizojnë një mesazh gabimi.

Qesja e letrës funksionon shumë mirë në procesin e gazit organik Duke e përdorur atë, të tëra mbeturinat organike mund të përdoren për të prodhuar gazin dhe plehun organik.

## Si të marr më tepër qese?

### A jetoni në shtëpi private/vilë?

Ju mundeni të porosisni më tepër qese në [www.vivab.info/minasidor](http://www.vivab.info/minasidor). Ju duhet të keni afër numrin tuaj të klientit dhe numrin tuaj personal. Ju mundeni të ngjitni një qese tek kapaku i enës suaj bojë kafe përpara shprazjes. Atëherë do t'ju sjellin më tepër qese gjatë shprazjes së ardhshme.

### A banoni në apartament?

Kontakttoni shoqatën tuaj banesore ose qiradhënësin i cili ju furnizon me qese.

Ju mund të merrni qese dhe mbajtëse për qese në qendrat tona të riciklimit ose në zyrat tona në Åkarevägen 10 në Falkenberg dhe në Hårdgatan 30A në Varberg.

A ju mungojnë qese ose mbajtëse qesesh për mbeturinat tuaja organike?